



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4263 prot.

Himarë, më 12.06. 2026

VENDIM

Nr. 23, Datë 04/06/2026

PËR

“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3 VJEÇAR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 1755 M2 TË PASURISË SË LLOJIT KULLOTË, ME NR.480, NË ZK 2311, KUDHËS, HIMARË, NË PRONËSI TË BASHKISË HIMARË, NË FAVOR TË TË Z. AGRON VELÇO”

AKTIVITETI:

“NGRITJE FIDANISHTE, MBJELLJE ULLINJ”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe neni 54; VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM-në nr. 592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1354, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”; VKM-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM-në nr. 559 ,datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim /përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike”. Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 04.06.2026, miratoi me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim për një afat 3 vjeçar të një sipërfaqe prej 1755 m2 të pasurisë së llojit kullotë, me nr.480, në zk 2311, Kudhës, Himarë, në pronësi të Bashkisë Himarë, në favor të të z. Agron Velço, për aktivitetin “Ngritje fidanishte, mbjellje ullinj”.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për ngritjen e urdhreve përkatës për zbatimin dhe ndjekjen e të gjithë hapave proceduralë ligjorë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

